

**MARRËVESHJE “PËR NDRYSHIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT  
NDËRMJET INSTAT DHE MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË”**

Ndërmjet

**INSTITUTIT TË STATISTIKAVE**

në vijim referuar si “INSTAT”

dhe

**MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në vijim referuar si “MASR”

Mbështetur në Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” si dhe duke patur parasysh vullnetin për bashkëpunimin e ndërsjellë, Palët bien dakord të kryejnë shtesat dhe ndryshimet në Memorandumin e Mirëkuptimit si vijon:

1. Në të gjithë përmbajtjen e memorandumit emërtimi “Ministria e Arsimit dhe Sportit” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” si dhe MAS zëvendësohet me MASR;
2. Në të gjithë përmbajtjen e memorandumit “Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar” zëvendësohet me “Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”;
3. Preambula e Memorandumit zëvendësohet me këtë përmbajtje:
  - INSTAT është institucioni përgjegjës për të siguruar që statistikat janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas parimeve të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, (në vijim referuar “Ligji i statistikave”);
  - Neni 13, pika 2 (ë) e ligjit të statistikave parashikon që INSTAT mund të hartojë, negociojë e të nënshkruajë memorandume mirëkuptimi me të gjitha agjencitë statistikore dhe me mbajtësit e të dhënave administrative, duke përfshirë organizimet e punës dhe detyrimet e palëve;
  - Neni 13, pika 1 (ç) e ligjit të statistikave INSTAT duhet të marrë pjesë në proceset e krijimit dhe zhvillimit të sistemeve të të dhënave administrative, për tu përdorur për qëllime statistikore;
  - Neni 25, pika 8 e ligjit të statistikave detyron të gjitha institucionet publike të njoftojnë INSTAT-in për çdo projektakt të propozuar për miratim në Këshillin e Ministrave apo

Kuvend, i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në veprimtarinë statistikore që ushtrohet në Republikën e Shqipërisë;

- Neni 33, pikat 1 e ligjit të statistikave parashikon që të gjitha institucionet qendrore dhe vendore i japin INSTAT-it të drejtën e hyrjes pa pagesë në regjistrat, skedarët e të dhënave dhe të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura, sipas përgjegjësisive përkatëse, në masën që është e nevojshme për nxjerrjen e statistikave, duke shmangur ngarkesat në përgjigje për njësitë statistikore;
- Neni 33, pikat 2 e ligjit të statistikave detyron institucionet publike të informojnë INSTAT-in për krijimin e çdo dokumentacioni të ri me të dhëna administrative apo për ndryshimin e atyre ekzistuese;
- Neni 31 i ligjit të statistikave detyron INSTAT-in të trajtojë si konfidenciale çdo të dhënë të mbledhur, përpunuar dhe ruajtur për nxjerrjen e statistikave zyrtare;
- Neni 40, pika 1 e ligjit të statistikave parashikon që ky ligj prevalon ndaj çdo dispozite të parashikuar në ligje të tjera, në bazë të të cilave ushtrojnë veprimtarinë institucionet publike, gjë që bëhet pengesë për dhënien dhe transmetimin e të dhënave administrative për qëllime statistikore ose për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të mbledhura vetëm për qëllime statistikore;
- MASR është autoriteti qendror në Republikën e Shqipërisë që administron të dhënat administrative për arsimin në vend, pjesë e Programit të Statistikave Zyrtare sipas ligjit 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar “Ligji i arsimit”);
- Neni 27, pika 1 e ligjit të arsimit parashikon që Sistemi kombëtar i informacionit për AFP-në zhvillohet dhe mirëmbahet nga ministria përgjegjëse për AFP-në dhe agjencitë zbatuese.
- Neni 27, pika 2 e ligjit të arsimit parashikon që Raportimi dhe publikimi i të dhënave zyrtare statistikore për sistemin e AFP-së është përgjegjësi e ministrisë përgjegjëse për AFP-në, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave.
- MASR, në kuadrin e hartimit të politikave zhvillimore në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë është e interesuar drejtpërdrejtë të përdorë statistikave zyrtare cilësore dhe koherente;

Si dhe duke patur parasysh që Sistemi Kombëtar Statistikor bazohet në një bashkëpunim të ngushtë mes INSTAT-it nga njëra anë dhe agjencive të tjera statistikore dhe mbajtësve të të dhënave administrative nga ana tjetër,

INSTAT dhe MASR bien dakort të nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit si vijon:";

4. Në Seksionin 2 "Pavarësia profesionale", paragrafi 1, togfjalëshi "agjencitë statistikore dhe institucionet" zëvendësohet me togfjalëshin "prodhuesit e statistikave zyrtare";

5. Në Seksionin 4 "Udhëzimet për standardet profesionale", paragrafi (1) ndryshohet si më poshtë:

"(1) INSTAT detyrohet të vendosë në statistikat zyrtare të gjitha përkufizimet statistikore, klasifikimet dhe nomenklaturat, në përputhje me konceptet dhe klasifikimet ndërkombëtare, aty ku është e mundur (Neni 14, pika 2 (e) e ligjit të statistikave).";

6. Në Seksionin 5 "E drejta e hyrjes dhe shkëmbimi i të dhënave", bëhen këto ndryshime:

a. Paragrafi (5) ndryshohet si më poshtë:

"(5) MASR-ja ndërhyt në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar për dhënien e informacionit statistikor të kërkuar nga INSTAT në nivel vendor";

b. Paragrafi (6) ndryshohet si më poshtë:

"(6) INSTAT furnizon MASR-në, pa pagesë, me publikime statistikore apo me të dhëna të tjera statistikore, të përpunuara nga INSTAT në nivel kombëtar apo të krahasuar me vende të tjera, pjesë e fushës së përgjegjësisë së MASR-së, në mbështetje të zhvillimit të strategjive dhe politikave.";

c. paragrafi (7), "Neni 15" zëvendësohet me "Nenin 31";

7. Në Seksionin 6 "Sigurimi i zbatimit të përshtatshëm të Programit" bëhen këto ndryshime:

a. Paragrafi (2) ndryshohet si më poshtë:

"(2) INSTAT është përgjegjës për zbatimin e përshtatshëm të Programit të Statistikave Zyrtare dhe raportimin e ecurisë së tij para Kuvendit.";

b. Paragrafi (3) shfuqizohet;

c. Në fund të paragrafit (5) shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) MASR njofton dhe merr mendim paraprakisht nga INSTAT-i për çdo akt ligjor ose nënligjor i cili i propozohet për miratim Kuvendit ose Këshilli i Ministrave dhe që mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në aktivitetet statistikore që kryhen në Republikën e Shqipërisë.";

8. Në "Aneks" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a. Termi "arsim i mesëm" zëvendësohet me termin "gjimnaz dhe arsim i mesëm i orientuar";
- b. Në pjesën "A. Arsimi Parauniversitar" hiqet pjesa e raportimit të të dhënave për Arsimin Profesional;
- c. Në pjesën "A. Arsimi Parauniversitar" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:  
"Niveli i raportimit në INSTAT, bazuar në riorganizimin e drejtorive dhe zyrave arsimore do të bëhet sipas zyrave vendore të arsimit parauniversitar dhe jo sipas rretheve";
- ç. Në pjesën B, titulli "Arsim Universitar" të zëvendësohet me "Arsim i lartë";
- d. Në pjesën "B. Arsim Universitar" hiqet pika: "Regjistrimet në konvikte në arsimin e lartë për fakultetet / institucion të arsimit të lartë publik";
- dh. Në pjesën B, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:  
"Në pasqyrat statistikore zyrtare, në raportimet në lidhje me stafin akademik, përveç titujve shtohet dhe kategoria."

9. Ndryshimet e parashikuara në këtë Marrëveshje për ndryshimin e Memorandumit të Mirëkuptimit hyjnë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve.

**PËR**  
**MINISTRINË E ARSIMIT SPORTIT DHE**  
**RINISË**

**BESA SHAHINI**

**MINISTËR**  
  
Data e nënshkrimit  


Nr. prot 621/1  
17.11.2.2020

**PËR**  
**INSTITUTIN E STATISTIKAVE**

**ELSA DHULI**

**ZËVENDËSKRYETAR I BORDIT**  
**DREJTUES**

  
Data e nënshkrimit  
22/10/2020  
